

## **Abstrakt**

Kuvendi i Republikës së Kosovës zgjedhet drejtpërdrejt nga populli dhe ka disa funksione si: funksioni ligjvënës, funksioni zgjedhor dhe mbikëqyrës. Kuvendi mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit.

Mbikëqyrja e ekzekutivit nga Kuvendi bëhet përmes mekanizmave të ndryshëm të përcaktuara me rregullore. Këto mekanizma përfshijnë miratimin e buxhetit, pyetjet parlamentare, interpelancat, raportet e zbatimit të ligjeve dhe debatet parlamentare për të diskutuar për politikën qeverisëse. Me anë të këtyre mekanizmave fuqizohet roli kushtetues i Kuvendit në raport me pushtetin ekzekutiv, e cila garanton rritjen e transparencës dhe e llogaridhënies së qeverisë. Në këtë punim do të trajtohen dhe analizohen format e kontrollit parlamentar të qeverisë, rendësia e këtij kontrolli me disa aspekte krahasuese me shtete të tjera për të shikuar se si qendron shteti ynë në raport me ato.

Në kapitullin e parë të këtij punimi është shtjelluar Kuvendi i Kosovës, përkufizimi sipas kushtetutes së Republikës së Kosovës, kompetencat e Kuvendit, komisionet e përhershme dhe të përkohshme, grupet parlamentare dhe praktikën e kalimit të deputeteve nga një grup në tjetrin.

Në kapitullin e dytë janë trajtuar instrumentet e kontrollit parlamentar, procedura e miratimit të buxhetit theksohet procedura e cila duhet të ndiqet deri të miratimi i buxhetit, karakteristikat e buxhetit si dhe paraqitja e raporteve periodike të qeverisë në parlament.

Ndërsa në kapitullin e tretë shtjellohen mjetet e jashtëzakonshme të kontrollit parlamentar, pyetjet e deputetëve, gjatë vitit 2023 dhe vitit 2018, organizmi i interpelancave ku janë trajtuar vitet 2018 dhe 2020 sa janë organizuar në Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendin e Shqipërisë si dhe krahasimet në mes tyre, instituti i votëbesimit dhe mosbesimit të qeverisë rasti 2010, 2017 dhe 2020, mocioni i mosbesimit të qeverisë dhe dorëheqja e kryeministrit.

Në kapitullin e fundit janë trajtuar aspekte krahasimore lidhur me formën e kontrollit parlamentar të qeverisë në shtetin e Anglisë dhe në shtetin e Francës.

**Fjalet kyqe;** kushtetuta, rregullore, qeveria, mocioni i mosbesimit, transparanca, llogaridhënie.